

STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Compass-Art” Sh.P.K.

Ne Sarande, sot me date 18.05.2020, ne respektim te kerkesave te Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”, dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, me vullnetin tim te lire une i nenshkruari:

- Edmond Rumani, i biri i Bashkim, i datëlindjes 30 Gusht 1984, lindur në Sarandë dhe banues në Sarandë, mbajtës i letërnjoftimit ID 033133080 me numër personal I40630113K me datë lëshimi 14/06/2016

shpall themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, si me poshtë vijon:

Neni 1

Shoqeria quhet **“Compass-Art” shpk** (shoqeri me pergjegjesi te kufizuar)

Neni 2

SELIA E SHOQËRISË

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne Sarande, ne adresen Lagjja 4, Rruga “Ismail Qemali” Nr.1, Sarande.

Me vendim te Asamblese se Ortakeve, selia e shoqerise mund te transferohet ne një rajon tjeter brenda territorit te Republikes se Shqiperise. Gjithashtu, shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise apo dhe jashtë tij.

Neni 3

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Kohëzgjatja e veprimtarisë se Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon qe prej datës se regjistrimit te saj ne Qendrën Kombëtare te Regjistrat.

Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SE SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Ndërtime civile, industriale dhe urbane
➢ Rikonstruksion objektesh civile dhe industriale
➢ Projekte arkitekturore dhe inxhinierike
➢ Import-Export, tregëti material ndërtimi.

Shoqeria mund te ushtroje cdo veprimatri tjeter tregetare dhe produhese e cila nuk ndalohet me ligji. (*Neni 7 i Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”*).

Neni 5

Kjo shoqëri mund te ndryshoje emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake, te rrisë ose zvogëlojë kapitalin sipas vendimeve te organeve drejtuese te kësaj shoqërie.

Neni 6

Kjo shoqëri mund te ndryshoje emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake, te rrisë ose zvogëlojë kapitalin sipas vendimeve te organeve drejtuese te kësaj shoqërie.

Neni 7

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë është ne vleren e 10,000 leke (dhjetemije), dhe perbehet nga 1 (nje) kuote, e ndare si me poshte:

1. Edmond Rumani, kontribuon me 1 (një) kuotë prej 10,000 (dhjetë mijë) lekë, ose 100% të kapitalit themeltar

Kapitali i shoqerise eshte nenshkruar dhe shlyer plotesisht.

Neni 8

Kapitali i shoqërisë mund të rritet ne te ardhmen, nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes se kuotave te reja nga ortake te rinj, vetëm me vendim unanim te Asamblesë se Ortakeve , ku do të miratohet si rritja e kapitalit themeltar ashtu dhe hyrja e ortakeve të ri. Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te gjithë ortakeve.

Neni 9

Zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërisë do te realizohet duke u bazuar ne dispozitat e veçanta qe parashikohen nga Ligji 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare"

Neni 10

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plete te normave qe përban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar ne datën e regjistrimit ne Qenden Kombetare te Biznesit.

Neni 11

Ortaket e shoqërisë me krijimin e kësaj shoqërie pjesën e kapitalit te derdhur prej tyre nuk mund t'a tërheqin. Kjo mund te behet vetëm pasi te nxirret bilanci i shoqërisë për fitimin e realizuar.

Neni 12

Kuotat e çdo anëtari përputhen me pjesën e tyre ne kapitalin e shoqërisë. Kuotat e tij anëtari i shoqërisë mund t'ua ofroje te treteve. Anëtaret e shoqërisë kane përparsi për blerjen e kuotave përpara personave te trete jashtë shoqërisë. Ortaku qe dëshiron te transferoje ose te shesë kuotat e tij i drejton një kërkesë me shkrim Organit Administrativ duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet te jete i arsyeshëm dhe te jete i njëjtë me atë qe do t'i ofrohet dhe një personi te trete jashtë shoqërisë si dhe te dhënat e blerësit. Organi administrativ jep përgjigje brenda 30 ditëve nga data

e njoftimit dhe duhet t'ua transmetoje ortakeve te tjerë ketë kërkesë dhe ortaket e tjerë duhet te japid një përgjigje brenda 3 muajve. Edhe e drejta e përparësisë për transferimin ose shitjen e kuotave duhet te ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Organit Administrativ.

E drejta e përparësisë për transferimin ose shitjen e kuotave është ne proporcion me kuotat qe zotëron secili prej ortakeve ne këtë shoqëri. Organi Administrativ pasi ka kaluar afati prej 3 muajsh, brenda 30 ditëve i komunikon ortakut qe shet kuotat e tij vendimin e ortakeve te tjerë per te blere te gjithë ose pjesërisht kuotat e tij. Ne rast se kuotat nuk shiten brenda shoqërisë, atëherë këto kuota brenda 90 ditëve i ofrohen personave te trete jashtë shoqërisë. Transferimi dhe shitja e kuotave duhet te bëhen me akte notieriale dhe një kopje e këtij akti duhet te depozitohet ne librin e Ortakeve.

Te gjitha transferimet e kuotave kane efekt mbi shoqërinë qe nga momenti i regjistrimit ne librin e Ortakeve dhe ne Qendren Kombetare te Biznesit. Kuotat prej 100 leke janë te pandashme. Ne rastet e bashkëpronësisë veprohet sipas ligjeve.

Neni 13

Emërtimi i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, emrat e administratoreve, si dhe emrat e Ortakeve duhet te jene te përmendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri dhe qe ju drejtohen te tetëve. Shoqëria ka vulën e saj me madhësi te zakonshme dhe me përbajtjen përreth saj.

Neni 14

Shoqëria vepron nen regjimin e pronës private dhe merr përsipër vete te drejtat dhe detyrimet kontraktuale dhe jashtë kontraktuale. Ortaku i shoqërisë drejton procesin për zhvillimin e aktivitetit te shoqërisë si dhe për detyrimet qe ka shoqëria ndaj te tretëve pa asnje kufizim.

Organet e shoqërisë janë:

- 1- Asambleja e Ortakeve te shoqerise.**
- 2- Administratori.**

Neni 15

A S A M B L E J A E O R T A K E V E

Organi me i larte i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori apo nga ortaket e percaktuar sipas nenit 84 te ligjit 9901. Anëtaret duhet te njoftohen jo me vone se 7 dite përpara dates se parashikuar dhe ne lajmërim duhet te jete shkruar vendi, ora dhe çështjet qe do te trajtohen. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës.

Neni 16

T E D R E J T A T E A S A M B L E S Ë

Asambleja e ortakeve ka kompetencat e mëposhtme:

- Ka te drejte te beje ndryshime ne statut ne rast kur janë dakord ortaket qe përfaqësojnë tre te katërtat e kapitalit themeltar.
- Ka te drejte te miratoje bilancin e shoqërisë dhe te beje ndarjen e fitimit.
- Ajo emëron administratoret, zëvendësin, ekspertet dhe revizoret kontabël.
- Ajo ka te drejte te beje përjashtimin e një ortaku nga shoqëria pér rastet e parashikuara ne ligj si dhe ne rregulloren e brendshme te shoqërisë.
- Ajo aprovon çdo lloj veprimi finansiar qe me ligj dhe me marrëveshje lihet ne kompetence te Asamblesë.
- Përcakton shpërblimin pér administratoret, ekspertet, revizoret kontabël.
- Ben transferimin e kuotave te te tretet.
- Ben lidhjen e kontratave pér dhënie dhe marrje te drejtash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqërisë si dhe kontrata ne lidhje me organet shtetërore pér pjesëmarrjen ne tender, ankande ose aktivitete te tjera te rëndësishme.
- Realizon blerje, shitje si dhe tjetërsim te pasurive te paluajtshme te shoqërisë etj.
- Ka te drejte te beje modifikimin e kontratës se shoqërisë.

Neni 17

- Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 pér qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 pér qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.
- Asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje pér veprimitarëne e administratorëve.

Neni 18

Kur pjesëmarrja ne asamble është normale vendimet qe merren brenda kufijve te kontratës se themelimit, Statutit e te ligjeve janë te detyrueshme per te gjithe, edhe per ata qe nuk kane diskutuar edhe pér ata qe nuk janë dakord.

Çdo ortak mund te përfaqësohet nga një ortak tjetër qe nuk është administrator. Asnjë i dërguar nuk mund te përfaqësoje me shume se një ortak.

Ne Asamblenë e Ortakeve marrin pjese nese është e nevojshme pér te dhene mendim pa te drejte vote eksperte, revizore etj.

Neni 19

Asambleja merr vendime te vlefshme ne rastet e parashikuara me poshtë:

a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime te vlefshme vetëm nese marrin pjese ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 pér qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë pér çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime te vlefshme vetëm nese ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 ténenit 88 të ligjit 9901.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet pér shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

b) Për ndryshimet ne Statut, zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarien e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise, Asambleja e Pergjithshme Shoqerise merr vendime te vlefshme me tri te katertat e votave te orakeve pjesmarres, siç percaktohet ne piken 1, te nenit 86 te ligjit “Per tregetaret dhe shoqerite Tregetare”.

Neni 20

Marrja e vendimeve te Asamblesë, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentet e tjera qe kane te bëjnë me te duhet te bëhen sipas legjislacionit ne fuqi për ketë qellim.

Neni 21

ADMINISTRIMI

Shoqëria administrohet nga Administratori i cili caktohet ne statutin e shoqërisë dhe me pas nga Asambleja e Ortakeve. Administratori/et qëndrojnë ne detyre për një periudhe kohore prej 5 vjet dhe ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftësie nga ana e secilit prej tyre, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e administratorit përkatës duke treguar me fakte demin qe i është shkaktuar shoqërisë nga paaftësia e tij pasi eshte dhënë mendimi per kete dem edhe nga specialistet përkatës.

Ata kane te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me përashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqërisë u'a jep shprehimisht ortakeve.

Administratori/et kane te drejte qe te gjitha kompetencat e përmendura me sipër t'i ushtrojnë se bashku apo vec e vec duke qene perjegjes individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë apo te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqërisë.

Ata nuk mund te marrin vendime te rëndësishme siç janë huante, te shesin pronat e shoqërisë, apo te bëhen dorëzanes ne emer te saj. Ata nuk mund te kryejne veprime te cilat i lihen ne kompetence Asamblesë se Ortakeve.

Asambleja mund te vendose lejimin e nje shpërblimi ne favor te Administratorit per kryerjen e detyrës përvçe pagimit te shpenzimeve.

Administrator i shoqerise do te jetë z. Edmond Rumani

Neni 22

Administrator mund te emërojë një ose me shume administratore te deleguar ose përfaqësues te thjeshte per te kryer veprime te veçanta duke përcaktuar fuqinë e tyre brenda kufijve e duke e respektuar statutin dhe ligjet ne fuqi dhe vendos dhënien e nje shpërblimi ne favor te tij. Detyrat e tyre do te përcaktohen ne nje rregullore te brendshme te shoqërisë.

Neni 23

Administratoret kane liri te plote për drejtimin e zakonshëm dhe te jashtëzakonshëm te shoqërisë dhe mund te kryejnë te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marrëveshje per realizimin e qëllimeve te shoqërisë duke përashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe ne Statut qe i takojnë Asamblesë se Ortakeve.

Neni 24

Administratoret kane te drejte te nënskruajnë për kapitalin e shoqërisë, kontrata te ndryshme, per furnizime publike private, te ndërmarrin veprime gjyqësore per dhe ne emër te shoqërisë, etj. Administratori mund te jepin prakura ne kufijtë qe i lejon Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh.

Administratoret janë te detyruar te mbajnë registrat e magazinimit te cilat vihen ne dispozicion te organeve kopetente per te mundësuar kryerjen e kontolleve prej saj. Administratoret e shoqërisë janë te detyruar te mbajnë inventar te rregullta nje here ne muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Administratoret.

Neni 25

MARRËDHËNIET E PUNËS

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës se punës dhe legjisacionit te punës ne fuqi. Shoqëria private merr përsipër te respektoje rregullat ne fuqi te punësimit dhe te punësuarit Jane te detyruar qe te respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punësuarit duhet te përgjigjen per demet qe i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Neni 26

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike përbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumenteve qe jane përcaktuar si te tilla nga Administratoret e kësaj shoqërie.

Neni 27

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABËL

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit, veprimtarinë e tij si dhe gjithe aktivitetin e shoqërisë i besohet nje eksperti ose revizori kontabël. Ky ekspert do te qëndroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Ortakeve cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

Neni 28

BILANCI DHE FITIMET

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do te mbyllte ne dt. 31 Dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi veçohen fondet si me siper dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund te transferohen lirisht jashte shtetit sipas dispozitave perkatese ligjore.

Neni 29

Ne rast se kapitali i shoqërisë per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, pronaret vendosin brenda 4 muajve për mundësinë e prishjes se shoqërisë.

Neni 30

SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Ne rast se shoqëria prishet per cdo lloj arsye Asambleja e Ortakëve përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose me teper likuidator dhe përgatit te gjitha dokumentet e nevojshme për çregjistrimin e saj nga Regjistri Tregtar.

Neni 31

DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

Për sa është shprehur ne ketë statut i referohemi Ligjit 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Statutit dhe rregullores se brendshme te shoqërisë. Çdo ndryshim behet ne te njëjtën mënyre siç është nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kësaj shoqërie.

Ky statut nënshkruhet rregullisht nga ortaket e shoqërisë ne Sarande, sot me **16.05.2020**.

ORTAKET E SHOQËRISË "Compass-Art" SH.P.K.

Edmond RUMANI

